



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni Pranveror**  
**Komisioni për të Drejtat**  
**dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**  
**Nr. 29**  
**Prishtinë, më 18. 02. 2010, në orën 13: 00**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

**P R O C E S V E R B A L**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sanije Aliaj, Kosara Nikoliq, Enis Kervan, Mursel Halili, Numan Baliq, Zylfi Merxha, Xhevdet Neziraj, Hetem Arifi, Sadik Idriz, Hafize Hajdini dhe Zafir Berisha.

**Munguan:** Bojan Stojanović dhe Müfera Şinik.

**Të ftuar:** **Naser Rrugova** - kryetar i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe Lirije Berisha - nga Departamenti për banim nga MPH- ja, përfaqësuesit nga OSBE - ja dhe ICO - ja.

**Pjesëmarrës të tjerë:** mbikëqyrës nga Zyra e Presidentit dhe KDI - ja.

**Nga Stafi Mbështetës:** Natasa Prica, Drita Çarkaxhiu dhe Dashurie Canolli.

**Mbledhjen e kryesoi: Sanije Aliaj**, zëvendëskryetare e Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 20. 01. 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave, në të cilat ekzistojnë drejta banesore me Raportin e Komisionit Funkcional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;
4. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar më 20. 01. 2010

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 20. 02. 2010, me vërejtjet e anëtarëve të Komisionit.

**Mursel Halili** theksoi se kuptimi i shkruar vetëm me një fjali në procesverbal e humb kontekstin e asaj që e kam thënë.

**Kosara Nikoliq** ka vërejte se në diskutimin e saj mungon fjalia 'Janë prezantuar tre versione të Projektligjit për shitjen e banesave dhe se nenet e tyre janë të ndryshme'.

**Numan Baliq** tha se në procesverbal mungon diskutimi i përfaqësueseve të ICO - së, dhe Xhevat Azemi- përfaqësuesi nga Agjencia Kosovare për Prona.

**Sanije Aliaj** u pajtua me parafolësit se në procesverbal duhet të përfshihen prononcimet e dhëna nga përfaqësuesit e ICO - së dhe të OSBE - së.

## 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave, në të cilat ekziston e drejta banesore me Raportin e Komisionit Funkcional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;

**Kryesuesja** theksoi se Komisioni për këtë mbledhje ka caktuar vetëm një pikë të rendit të ditës. I njoftoi se për këtë takim është ftuar Naser Rugova- kryetar i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor. Në vend të tij prezantoi Zef Morina - anëtar Komisioni, ndërsa nuk kemi informatë për mos prezantimin e Lirije Berishës, nga Departamenti për banim të MPH - së. Në vazhdim tha se Komisioni do të vazhdojë procedimin e mëtejme në këtë projektligj.

**Xhevdet Neziraj** diskutoi, se gjatë mbledhjes së kaluar na është thënë se Projektligji ka mungesa si në përmbajtje ashtu edhe në strukturë, prandaj Komisioni për këtë takim është pajtuar që të ftojë ekspertë, të cilët do ta afrojnë Draftpozim të ri. Në vazhdim theksoi se Komisioni deri sot nuk ka marrë asnjë propozim konkret, prandaj procedura e tillë e vonuar nuk do të sjellë zgjidhje definitive për finalizimin e këtij projektligji.

**Elita Vokshi** në fjalën e saj tha se janë të pranishëm përfaqësuesit e ICO - së Katrin, nga OSBE – ja, Arben Kelmendi dhe nga Departamenti për të drejtat e njeriut, përkatësisht zyra që merret me çështje pronësore. Zyra e OSBE - së, në vitin 2007 ka punuar në Draftligj, ku janë dhënë komentet e tyre. Në vazhdim tha se tani është Drafti final dhe se kolegët në fjalë janë të thirrur si ekspertë të kësaj fushe, nëse është nevoja çdo ditë të punojnë me Komisionin. Në cilësinë e vëzhguesve do të marrin pjesë edhe përfaqësuesit nga Zyra Amerikane, edhe pse ata drejtpërdrejt nuk janë të involvuar. Kërkesa e saj është se në një afat kohor prej dy javësh, vërejtjet e shkruara nga anëtarët e Komisionit të dërgohen në zyrat e saj, më pas me angazhim të ekspertit nga Komisioni Evropian do t'i paraqesim komentet tona.

**Numan Baliq** theksoi se nuk ka pasur për qëllim ta zgjasë shqyrtimin e Projektligjit për shitjen e banesave, në të cilat ekziston e drejta banesore, por problematika qëndron se

përfaqësuesit e komuniteteve kanë paqartësi lidhur me këtë projektligj dhe se komentet e tyre nuk dinë t'i prezantojnë siç duhet në mënyrë juridike ose administrative.

Marrëveshja e Komisionit ka qenë që përfaqësueset nga ICO – ja, Siva dhe Bardha t'i dërgojë propozimet e tyre. Mirëpo sipas diskutimit që dëgjuam nga Vokshi, sot kemi një tjetër fakt se OSBE - ja ka përgatitur një Draftprojekt, por ai dokument ende nuk iu është shpërndarë anëtarëve të Komisionit. Ai theksoi se duhet të shqyrtohen të gjitha propozimet e ekspertëve, të secilit anëtar dhe të atyre që janë përfaqësues të komuniteteve. Në një mbledhje të radhës duhet të gjendet një zgjidhje përfundimtare për procedim të mëtejshëm të këtij projektligji. Në fund, theksoi se nuk pajtohet që të bazohen në afat kohor.

**Sw-K-Katarina** tha se lidhur me takimin që është mbajtur me kryetarin e Kuvendit, përfaqësuesin e ICO - së, Piter Faith dhe me kryetarët e grupeve parlamentare, se nga ai takim është marrë qëndrim që sa më parë të gjendet zgjedhja përfundimtare në këtë projektligj. Përfaqësuesit e zyrës së OSBE - së, ICO - së, EULEX- it dhe të Ambasadës Amerikane janë të gatshëm të punojnë bashkërisht me Komisionin, deri sa të vijë eksperti nga Komisioni Evropian.

**Kosara Nikoliq** kërkoi nga përfaqësuesit e ICO - së që të caktohet afati real për përfundimin e Draftprojektit, për ta dorëzuar në Komision, pastaj Komisioni do të vazhdojë punën e tij.

**Kryesuesja** në fjalën e saj tha se komisioni, pas një periudhe të gjatë përsëri është thirrur të ofrojë propozime konkrete lidhur me dispozita që nuk garantojnë të drejtën banesore në këtë projektligj. Ajo propozoi që Komisioni të formojë një grup të punës, në afat prej një ose dy javësh të shqyrtojë nen për nen këtë projektligj në kontinuitet me ekspertë të OSBE- së, të ICO -së, Zyrën Amerikane, me hartuesit e këtij projektligji dhe me të gjithë përfaqësuesit e interesuar të komuniteteve. Ajo vlerësoi se komisioni me ndihmën e ekspertëve do t'i evitojë vërejtjet eventuale, me ç' rast Projektligji duhet të miratohet në Kuvend.

**Zef Morina** theksoi se Komisioni Funkcional në bashkëpunim me zyrën e OSBE- së ka nxjerrë amendamentet e Projektligjit për shitjen e banesave, në të cilat ekziston e drejta banesore. Gjithashtu më 15. 03. 2009 ka nxjerrë Rekomandimin, për t'u votuar në Kuvend. E shprehu shqetësimin se çështja e prolongimit të këtij projektligji është mos disponimi i mirë i këtij komisioni ose mosndërhyrja në mënyrë profesionale në këtë projektligj. Ai propozoi që grupi i punës i Komisionit Funkcional dhe i Komisionit për Komunitete edhe një herë t'i analizojë amendamentet e Komisionit Funkcional dhe, nëse ka vërejtje eventuale, bashkërisht të evitohen, që Projektligji të miratohet në Kuvend.

**Zafir Berisha** në diskutimin e tij tha se nënkomisioni ka qenë i interesuar ta pengojë këtë projektligj, i cili deri sot nuk është miratuar në Kuvend.

Ai propozoi që Komisioni të formojë një grup të punës, i cili në afat prej 15 ditësh do të fillojë leximin nen për nen të Projektligjit. Mendon se, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e interesuara të kësaj fushe dhe me Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, do të arrijmë që të përfundojë procedimi i këtij projektligji dhe sa më parë të bëhet leximi i tij në Kuvend.

**Idriz Sadik** - U pajtua me qëndrimin e parafolësit , se duhet të formohet grupi punës, i cili do të punojë në bazë të Draftpropozimeve të zyrës së OSBE - së, ICO - së dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, që ky projektligj të procedohet në Kuvend.

**Bardha Kastrati** përfaqësuese nga ICO - ja mendon se për këtë takim është pritur të jenë të pranishëm edhe hartuesit nga MPH- ja, që t'i afrojnë opinionet e tyre. Ajo vlerësoi se në këtë komision do të angazhohen përfaqësuesit e OSBE - së, deri sa të arrijë eksperti nga Komisioni Evropian. Ajo propozoi që të mos caktohet afat kohor, por secili anëtar i Komisionit të afrojnë propozime me shkrim, në nenet që nuk funksionojnë, andaj propozimet konkrete do t'i shqyrtojmë edhe me ekspertin e Komisionit Evropian, ku do të nxjerrim Daftin final, të cilin do ta shqyrtojmë në këtë komision.

**Zylfi Merxha** tha se është për t' u bregosur që ky projektligj nuk është përfunduar për arsye të ndërhyrjeve individuale në këtë komision. Ai nuk u pajtua të formohet grupi i punës, sepse në këtë komisioni ka juristë dhe se e kemi materialin nga ekspertët e OSBE – së dhe ICO - së. Komisioni në bashkëpunim me ekspertët e kësaj fushe të punojë dhe të arrijë zgjidhje reale lidhur me këtë projektligj.

**Hetem Arifi** dhe **Hafize Hajdini** u pajtuan me mendimin e Zafir Berishës, se duhet të formohet grup i punës, që në afat prej 15 ditësh, bashkërisht të punohet me përfaqësuesit e OSBE - së, ICO - së, hartuesit e Projektligjit dhe të dalin me propozime konkrete që projektligji të votohet sa më parë në Kuvend.

Komisioni për të Drejtat e Interesat e Komuniteteve dhe Kthim pas diskutimit lidhur me hartimin e amendamenteve të nënkomisionit, nxori këtë:

## **PËRFUNDIM**

*Grupi i punës në përbërje nga pesë anëtarë; nënkryetare e Komisionit, Sanije Aliaj, anëtarë -Numan Baliq, Kosara Nikoliq, Mursel Halili, Hafize Hajdini dhe me përfaqësuesit e OSBE - së, ICO - së dhe hartuesit e ligjit, do të mbajë mbledhje më 23 .02. 2010 në orën 13 :00.*

### **3. Të ndryshme**

**Kryesuesja i** njoftoi anëtarët e Komisionit rreth zhvillimit të vizitës në Zvicër. Ajo diskutoi lidhur me përvojën e mirë të arritur në aspektin e arsimit, përkatësisht respektimi i gjuhëve në sistemin arsimor. Ajo propozoi që Komisioni, sot dy javë në orën 11:00, të mbajë një mbledhje, në të cilën do të ftohet Ramush Lekaj, me përfaqësuesit e komuniteteve që punojnë në MASHT, të afrojnë opinionet e tyre lidhur me kurikulin e zhvillimit të procesit arsimor.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

#### **E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Zëvendëskryetarja e parë Komisionit**

-----  
**Sanije Aliaj**